

Roberto Morozo della Rocca*

ÇËSHËTJA SHQIPTARE NË BALLKAN**

Me termin çështja shqiptare kuptohet mosbashkimi në një shtet të vetëm i trojeve të banuara nga shqiptarët. Nga pikëpamja nacionale, kjo është çështja e Shqipërisë së Madhe (termi “Shqipëri e Madhe” nga të huajt përdoret gabimisht në vend të shprehjes “Shqipëri Etnike” – vër. e Redaksisë). Thënë me fjalë të tjera, është çështja e çuarjes deri në fund të ideve të Rilindjes Kombëtare. Shqiptarët sigurisht nuk janë të vetmit në Ballkan që ëndërojnë për një shtet-komb më të madh. Për shkak të ndër-

* Roberto Morozzo della Rocca është lindur në Romë më 1955. Është profesor i historisë së Evropës Lindore në Universitetin Roma III. Si specialist i periudhës së historisë bashkëkohore ka shkruar disa libra në të cilët trajton probleme interesante: “*Kombi dhe feja në Shqipëri (1920-1944)*”, Bolonjë, 1990; “*Kombet nuk vdesin, Rusia revolucionare, Polonia e pavarur dhe Selia e Shenjtë*”, Bolonjë, 1992; “*Kisha ortodokse. Një histori bashkëkohore*”, Romë, 1997 dhe “*Shqipëria rrënjët e krizës*” (Albania le radici della crisi) përkthyer prej italishtës nga Shpëtim Cucka dhe botuar nga Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, Tiranë, 2000.

Redaksia në shenjë respekti për interesimet e autorit për problemet e historisë shqiptare, nxori nga libri i fundit artikullin që po e botojmë. Artikulli botohet pa ndryshime, ashtu siç i ka parë e vështruar problemet autori.

** Çështja Shqiptare në Ballkan më shumë se asnjë çështje e popujve të tjerë të këtij rajoni nuk përkon (përputhet) me termin “*Shqipëri dhe shqiptarë*”. Këto terma nuk janë të barazvlefshëm dhe si të tillë duhet dalluar nga njëri-tjetri. Shqipëria si shtet përfshin brenda kufijve të vet rreth gjysmën e shqiptarëve. Gjysma tjetër jeton në zona të ndryshme të Ballkanit, kryesisht në fqinjësi si: në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Preshevë e Bujanoc, në Çamëri e që është pjesë e një historie të dhimbshme. Një qasje që do të kapte vetëm realitetin e Shqipërisë si shtet do të ngushtonte kuptimin e entitetit shqiptar. Mirëpo, nisur nga realitetet e krijuara, në veçanti pas lutës në Kosovë, autorë të huaj varësisht nga interesimi për objektin e kërkimit i referohen studimit të trevës së caktuar të shqiptarëve si: të Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë, etj. Trajtimi që i bën Della Rocca kësaj çështjeje të historisë bashkëkohore është interesante dhe si e tillë konsiderohet e drejta e autorit për t’i shikuar dhe vlerësuar problemet që shqyrton.

thurjes që ekziston midis popullsisë të vendosura në të njëjtin territor, si dhe të ngjarjeve të ndërlikuara historike të karakterizuara nga periudha të ndryshme sovraniteti e pushtimi, çdo popull pretendon për më shumë hapësirë të sovranitetit të vet. Përveç Shqipërisë së Madhe ka synime për një Kroaci të Madhe, Serbi të Madhe, Maqedoni të Madhe, Greqi të Madhe, Bullgari të Madhe. Shkurt, Shqipëria e Madhe, e realizuar gjatë Luftës së Dytë Botërore nën tutorësinë e Italisë së Musolinit, ringjall edhe të tjera megaide për një shtet etnik homogjen ose etnikisht të spastruar, të cilat janë bërë të modës nëpër kryeqytetet ballkanike të viteve '90.

Për ndryshim me numrin e vogël të pakicave etnike brenda kufijve të shtetit shqiptar, jashtë jeton një numër i madh i shqiptarëve. Në Kosovë jetojnë rreth dy milion shqiptarë, që zhvillojnë një ballafaqim të ashpër me pakicën sllave. Aktualisht Kosova ndodhet nën sovranitetin e Federatës së re jugosllave (libri është botuar para luftës dhe intervenimit të NATO-s në Kosovë - shën. i Redaksisë). Serbët e Kosovës nuk përbëjnë sot veçse 10% të popullsisë, nga 25% që ishin në vitet '20 të shekullit XX. (Përqindja e fundit është arritur si rezultat i kolonizimit të Kosovës dhe shpërnguljes së shqiptarëve midis dy luftërave botërore. – shën. i Redaksisë).

Në Mesjetë kjo krahinë përbënte zemrën e perandorisë serbe. Shqiptarët depërtuan gjithnjë e më shumë në Kosovë gjatë sundimit osman: sipas interpretimit të tyre në të vërtetë ka qenë fjala për një rikthim të tyre, sepse ilirët ose dardanët, të cilët i mbajnë për paraardhësit e tyre, kanë qenë dëbuar ose mënjanuar nga Kosova prej dyndjeve sllave në mbarrim të mijëvjeçarit të parë. Në Kosovë është një rregull i pashkruar, që për të mposhtur demografikisht serbët shqiptarët duhet të lindin shumë fëmijë dhe kjo po vihet re për dhjetëvjeçarë me radhë.

Shqiptarët e Kosovës gëzonin një pozitë të lakmueshme në vitet e fundit të regjimit të Titos: kishin autonomi politike e administrative, duke pasur pothuaj një shtet të vetin në gjiun e federatës, aq sa serbët e ndienin veten atje të diskriminuar e të shtypur. Pas daljes së Milosheviqit si paladin i rizgjimit serb, gjendja duke filluar nga viti 1989 u përmbys.

Shqiptarët tani i janë nënshtruar një regjimi policor armiqësor dhe janë përjashtuar nga strukturat publike. Plani serb, së paku duke filluar nga viti 1994, ka synuar t'ua bëjë të vështirë shqiptarëve jetën në Kosovë me qëllim që t'i shtrëngojë të emigrojnë. Në fakt rreth 300.000 shqiptarë nga Kosova, midis tyre jo pak të rinj në moshë ushtrie, kanë emigruar. Si kundërveprim shqiptarët kanë organizuar një lloj shteti alternativ ndaj atij të serbëve, shtet i cili nuk ka sovranitet, por mbështetet në një ekonomi krejtësisht private, me shkolla e spitale të vetadministruara dhe në një epërsi demografike dërrmuese.

Me anë të një votimi të fshehtë zhvilluar në tetor të vitit 1991 shqiptarët e Kosovës vendosën njëzëri të shpallin pavarësinë nga Serbia, për sa kohë që nuk është pranuar nga asnjë shtet në botë, natyrisht me përjashtim të Shqipërisë. Veç kësaj, kanë zgjedhur fshehurazi edhe një parlament e një president. Ky i fundit, Ibrahim Rugova, një intelektual aristokratik me nuancë atdhetarizmi të shekullit të kaluar, është bërë i njohur si një lloj “Gandi i Ballkanit” ose “Haveli shqiptar”, për shkak se është për-krahës i vendosur vetëm i rrugës së qëndresës paqësore ndaj kundërshtarit etnik. Së bashku me Nënë Terezën me prejardhje shqiptare nga Shkupi, Rugova është përfaqësuesi më i njohur në botë i popullit shqiptar.

Në Maqedoni, krahinë me të kaluar të moçme historike, por pa tradita shtetërore dhe që nuk ka shumë që është krijuar si shtet i pavarur pas shpërbërjes së Jugosllavisë, jeton një pakicë shqiptare, që pretendon se përbën 40% të popullsisë së vendit, në mos më shumë. Regjistrimet e fundit të Jugosllavisë së bashkuar jepnin shifra mjaft më të ulëta lidhur me shqiptarët e Maqedonisë. Maqedonët me kombësi sllave pohojnë mbi bazën e regjistrimit të vitit 1994 se shtetasit shqiptarë të vendit të tyre nuk përbëjnë më shumë se 21% të popullsisë. Mund të gjykohet me realizëm se shqiptarët bëjnë 20-30% të të gjithë shtetasve maqedonë. E gjithë zona perëndimore e Maqedonisë përgjatë kufirit me Shqipërinë është e banuar dendur me shqiptarë, aq sa është e lehtë të përfytyrohet një zgjerim i zonës së sovranitetit të Tiranës mbi këto troje, në rast se republika e re do të shpërbëhej.

Duke qenë se tani për tani një ndryshim i kufijve është i pamundur, shqiptarët e Maqedonisë kanë pranuar të bashkëpunojnë brenda disa caqeve me qeverinë e Shkupit dhe njëra nga dy partitë etnike shqiptare ka hyrë në koalicionin qeverisës. Drejtimi i urtë i presidentit Gligorov ndihmon bashkëjetesën midis maqedonëve dhe shqiptarëve. Por Gligorovi është i moshuar dhe i dobësuar shëndetërisht nga një atentat i rëndë i kohëve të fundit. E ardhmja e Maqedonisë është e pasigurt jo aq për shkak të ekspansionizmit grek ose të pretendimeve serbe sa për shkak të marrëdhënieve të vështira midis shumicës sllave dhe pakicës shqiptare, e cila në një të ardhme jo të largët, duke parë rritjen e madhe demografike, mund të kthehet në shumicë.

Jashtë Shqipërisë jetojnë edhe shqiptarë të tjerë. Afro 100.000 jetojnë në Mal të Zi. Në Greqi ka 30.000 (ka gjithashtu edhe 200.000 grekë shqipfolës me vetëdije etnike greke). Në tërësi shqiptarët që jetojnë përreth kufijve të Shqipërisë janë afro tre milionë, diçka më pak sesa banorët e vetë Shqipërisë. Prej këtej rrjedh edhe shprehja e përhapur e “pavarësisë së papërfunduar”, që ka të bëjë me ngjarjet e vitit 1912. Kudo në Shqipëri është bërë zakon të flitet për atë që “gjysma e popullit shqiptar

jeton jashtë kufijve” dhe që “Shqipëria është i vetmi vend në Evropë që është rrethuar nga të gjitha anët prej trojeve të banuara nga po ai popull”.

Veç kësaj, sipas përfytyrimit të tyre, shqiptarët janë të pranishëm në numër të madh edhe gjetiu. Vendndodhja, me një shtrirje të madhe, e paraardhësve të tyre ilirë në Ballkan lë të kuptohet në kuadrin e një vizioni etnik nationalist se gjak shqiptar mund të gjesh kudo në Ballkan. Po kështu, qarkullimi i dendur i shqiptarëve brenda Perandorisë Osmane të shtyn të besosh se shumë turq e grekë janë me prejardhje shqiptare. Personalitete të larta shqiptare janë të bindura se kroatët janë në të vërtetë shqiptarë. Veç kësaj, në Shqipëri është i përhapur mendimi se një pjesë e madhe e popullsisë turke, deri gjysma, janë shqiptarë të asimiluar. Koncepti i asimilimit nuk është i pranueshëm për nacionalizmin natyralist shqiptar, i cili mbështetet mbi lidhjet e gjakut. Me fjalë të tjera, këta lloj turqish nuk kanë pushuar kurrë së qeni shqiptarë. Trojet e Greqisë së sotme kanë qenë banuar dhe rrahur nga shumë shqiptarë në kohën e osmanëve: në Tiranë llogarisin se edhe një numër i madh grekësh janë me prejardhje shqiptare, të asimiluar ndër të tjera përmes fesë ortodokse, që është bartësja e kulturës greke. Të tilla skicime nuk janë të pathemelta, por sigurisht në fushën etnike shqiptarët kanë një fantazi jo më të vogël sesa popujt e tjerë ballkanikë.

Gjithsesi historia ka peshën e vet. Sot nuk ka të dhëna që masa kroa-tësh, turqish ose grekësh të ngulmojnë në prejardhjen e tyre shqiptare. Midis diplomatëve turq qarkullon një histori ironike e një kolegu të tyre shqiptar të kohës së Enver Hoxhës, të akredituar në Ankara, i cili prej çdo nëpunësi turk që takonte dëgjonte me kënaqësi, në formën e një komplimenti, për prejardhjen e tyre të largët nga Shqipëria; shqiptari i entuziazmuar vendosi t’i mblidhte të gjithë miqtë turq për të krijuar një lëvizje të shqiptarëve në Turqi, por nuk bëri tjetër veçse shkaktoi ilaritetin e të gjithë bashkëbiseduesve të vet.

Në përputhje me këtë qëndrim të përgjithshëm qasja e shqiptarëve ndaj ngjarjeve në ish-Jugosllavi nuk ka asnjë nuancë. Fajtorë për tragjedinë janë vetëm serbët. Lufta civile midis sllavëve të jugut shpjegohet brenda caqeve të moralit e jo të politikës. Serbët janë populli që ka kundërshtuar historikisht popullimin shqiptar në zonën e veriut. Konflikti në rajonin e gjerë që shkon nga Shkodra deri në Nish vazhdon prej shekujsh. Po kështu urrejtja e ndërsjellë. Ankohej kohët e fundit historiani shqiptar Kristo Frashëri: “Beogradi flet vazhdimisht keq për ne. Serbët na përbuzin si të ishim ciganë; na trajtojnë si të ishim inferiorë. Tragjedia e Kosovës vazhdon...”. Si provë të marrëzisë nacionaliste serbe shqiptarët kanë qejf të përmendin tezën e një akademiku serb, i cili tha në fillim të shekullit se shqiptarët e maleve ishin njerëz me bisht.

Qeveria e Tiranës lavdohet nga të gjithë për faktin se gjatë krizës jugosllave është treguar e përmbajtur. Natyrisht, Shqipëria nuk hyri në luftë. Po si mund ta bënte këtë kur ndodhej në një gjendje ekonomike katastrofike? Një qëndrim luftënxitës në agim të një epoke të re a nuk do ta kishte vënë në pikëpyetje rimëkëmbjen e vendit? Dhe, a nuk do ta kishte qar dëm kapitalin e simpatisë, që Shqipëria gëzonte në opinionin publik ndërkombëtar? Berisha ka deklaruar: "Për ne përparsi ka parandalimi i konfliktit. Jemi një vend që ka humbur pesëdhjetë vjet në shekullin XX dhe fitimi i kohës së humbur është objektivi ynë kryesor". Nga ana tjetër, gjendja e ushtrisë shqiptare vitet e kaluara ishte katastrofike dhe aspak e përshtatshme për një mësymje: mjete të blinduara që nuk ishin në gjendje as të dilnin nga vendstrehimet; avionë të vjetër e pa pjesë këmbimi; anije të ndryshkura; në gjendje gatishmërie ishin vetëm shumë topa e mortaja të lehta, armë të shumta mbrojtëse antitank e kundërajrore, së fundi një numër tejet i madh armësh të lehta për të ashtuquajturën mbrojtje territoriale popullore.

Qeveria e Tiranës ka ndjekur në fushën e jashtme një politikë interesash shqiptare qoftë nëpërmjet armiqësisë me serbët qoftë edhe duke kushtëzuar së brendshmi Maqedoninë, pasi ka njohur më parë e kundër dëshirës pavarësinë e saj. Kohë më parë Berisha ka propozuar që perëndimorët të bombardonin Beogradin. Në vitin 1993 kryeministri shqiptar Aleksandër Meksi fliste lidhur me mundësinë e një lufte në Kosovë dhe pohonte se për furnizimin me armë të bashkatdhetarëve kosovarë gjithçka ishte gati. Në vitin 1996 Berisha për arsye të brendshme politike nuk e mbështet më Rugovën dhe sponsorizon kundërshtarin e këtij Adem Demaçin, përkrahës të një vije më të ashpër ndaj serbëve. Në të vërtetë Tirana ka hequr dorë nga pavarësia e menjëhershme e Kosovës për shkak të kundërshtimit të të gjitha fuqive dhe është kthyer te kërkesa për ndërkombëtarizimin e problemit, ndërkohë që serbët e konsiderojnë thjesht çështje të brendshme.

Briri tjetër i çështjes shqiptare në Ballkan, më pak i dhimbshëm se ai serb, është briri grek. Ashtu sikurse midis shqiptarëve dhe serbëve, ekzistojnë konflikte të vjetra edhe midis shqiptarëve dhe grekëve. Qarqet nacionaliste greke, jo domosdo të lidhura me qeverinë e Athinës, por sidoqoftë me ndikim të madh mbi opinionin publik, vazhdojnë të ruajnë synime ndaj Shqipërisë së Jugut, e cila nga grekët quhet zakonisht Epiri i Veriut. Prania e një pakice greke në Shqipërinë e Jugut mund të përligite një zhvendosje të mundshme të kufijve grekë drejt veriut. Në Tiranë pakica greke e jugut përfilllet me bezdi, si të ishte një kolonë e pestë e armikut. Për këtë arsye ajo i nënshtrohet njëfare shtypjeje politike e kulturore, për të cilën u fol më lart. Nga ana e vet Greqia ka marrë më se

një herë masa armiçësore ndaj Shqipërisë, në mënyrë të veçantë duke dëbuar në mënyrë brutale e në masë refugjatët shqiptarë.

Tensioni në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë do të dukej paradoksal, sikur të mos njiheshin të dy nacionalizmat që përbëjnë bazën e tij.

Greqia, që ka një gjendje gjeopolitike të vështirë për shkak të përpjasjeve me fqinjën e fuqishëm turk, do të duhej të kishte interes për t'i zbutur shqiptarët, me qëllim që të mos lejonte lidhjen e tyre të ngushtë me Turqinë pikërisht në funksion antigrek. Shqipëria nga ana e saj është në gjendje varësie ekonomike nga Greqia për shkak të dërgimit të refugjatëve atje. Me qindra mijëra shqiptarë, një pjesë stinorë, punojnë në Greqi dhe përbëjnë kështu një shtyllë për ekonominë shqiptare. Në vitin 1996 marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë përmirësohen pak përpara se kriza e piramidave të krijojë një gjendje tejet delikate në kufirin midis dy vendeve.

Kriza aktuale shqiptare mund të sjellë ndryshime në politikën e jashtme të qeverive të ardhshme të Tiranës, por jo aq sa të ndryshojë të dhënat e përgjithshme të çështjes shqiptare në Ballkan. Kjo çështje shtrohet për hir të numrit të popullsisë shqiptare. Falë një lindshmërie të paparë në vendet evropiane shqiptarët po e lënë pozicionin e një populli të vogël të Ballkanit, sikurse janë konsideruar prej kohësh (që të mos flasim për kohën kur Bizmarku pohonte se kombi shqiptar nuk ekzistonte). Shqiptarët nuk janë tanimë numerikisht shumë poshtë serbëve, grekëve, bullgarëve. Vit pas viti shqiptarët po e pakësojnë inferioritetin demografik ndaj këtyre popujve.

Një e dhënë domethënëse: të rinjtë shqiptarë në moshë ushtrie, të llogaritur në bazë të gjashtë millionë shqiptarëve që banojnë në Ballkan, janë më të shumtë në numër se të rinjtë serbë, grekë a bullgarë në moshë ushtrie. Serbët, grekët, bullgarët, popuj të krahasueshëm për nga numri i popullsisë, rreth dhjetë milionë vetë, kanë një moshë mesatare mjaft më të lartë se shqiptarët e shtueshëm.

Lufta në ish-Jugosllavi e ka lënë në hije çështjen shqiptare, me përjashtim të tensioneve në Kosovë. Në arenën ndërkombëtare flitet relativisht pak për unitetin politik të shqiptarëve të përhapur në Ballkan. Këtë ta sugjeron në të vërtetë edhe një vështrim realist i problemit. Asnjë fuqi nuk dëshiron tani për tani trazira e konflikte të tjera në Ballkan: çështja shqiptare është shtyrë për një të ardhme të Ballkanit, ku shpresohet se do të ndihet më pak vula e nacionalizmave. Shqipëria e Madhe mbetet në mendjen e shqiptarëve, por jo në kalendarin e tanishëm politik, i cili parashikon në radhë të parë kapërcimin e krizës së rëndë të shkaktuar nga përkeqësimi i gjendjes politike dhe falimentimi i piramidave.

Shqipëria dhe Italia

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë gjatë gjithë shekullit XX njohin faza shumë intensive, por edhe rënieje pothuaj të plotë të shkëmbimeve. Deri në vitin 1945 Shqipëria është shumë e pranishme në politikën e jashtme të Italisë. Opinioni publik italian interesohet për vendin e vogël buzë Adriatikut, i cili në vitet '30 ka më pak se një milion banorë. Kalojnë më shumë se dyzet vjet errësimi, deri sa ndryshimet politike të viteve 1990-91 sjellin një rizbulim të Shqipërisë nga ana e Italisë, njëkohësisht me braktisjen nga ana e Tiranës të mbylljes hermetike dhe ksenofobe ndaj kontakteve me botën.

Që nga fillimi i shekullit XIX e deri në Luftën e Dytë Botërore Shqipëria është një lloj toke e lakmuar për Italinë, politika e jashtme e së cilës nuk e përjashton frymën nacionaliste dhe imperialiste tipike për shumë fuqi të asaj kohe, dhe sidomos pas vitit 1922, kur në Romë vjen në fuqi fashizmi. Një pushtim i pjesëshëm i territorit shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore dhe në periudhën e parë pas mbarimit të luftës mbyllet pa lavdi për italianët. Në vitin 1920 në Vlorë kryengritësit atdhetarë shqiptarë i detyrojnë trupat italianë të tërhiqen nga vendi. Italia e Musolinit fillon një politikë marrëdhëniesh të ngushta me Ahmet Zogun, që e qeveris në mënyrë diktatoriale Shqipërinë duke filluar nga viti 1925 (nga viti 1928 do të bëhet mbreti Zog). Qeveria e Romës e mbështet financiarisht Zogun dhe kërkon si shkëmbim që Shqipëria të veprojë si vend aleat, në mos edhe si vend satelit, i Italisë.

Zogu është një bajraktar, me fjalë të tjera kreu i një klani të madh në një zonë qendrore të Shqipërisë së Veriut, përreth lumit Mat. Është rritur në Stamboll si peng i sulltanit për të siguruar besnikërinë e të atit. Ka qëndruar gjithashtu dy vjet në Vjenë, si i internuar i shquar, për shkak se austriakët, që kishin pushtuar Shqipërinë e Veriut gjatë luftës së madhe u mërzitën duke e pasur një ditë aleat e ditën tjetër kundërshtar. Zogu njihet në disa aspekte të politikës osmane, por edhe të politikës perëndimore. Qeveria e tij do të jetë perëndimore për nga parimet dhe lindore për sa i përket zbatimit të tyre.

Zogu në marrëdhënie me Italinë përfaqëson shembëlltërinë e sjelljes tipike të shqiptarit ndaj të huajve. Është në të njëjtën kohë edhe mik edhe armik, mosbesues dhe befaz pastaj i gatshëm për bashkëpunim, jo fort i prirur për mirënjohje, i kujdesshëm për të kthyer në të mirë të tij planet e bashkëbiseduesit më të fuqishëm, i bindur në vetvete se në marrëdhëniet me të tjerët këta janë kurdoherë borxhlinj përpara tij, i sigurt se nuk ka për të pësuar kushtëzime më të mëdha nga përfitimet e parashikuara. Marrëdhëniet midis Zogut dhe Italisë kanë një vlerë paradigmatishtë që ndri-

çon marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe italianëve edhe përtej epokës midis dy luftërave.

Italia nuk kursen ndihmat ekonomike ndaj shtetit të Zogut për ta lidhur pas vetes dhe për të siguruar kështu ndikimin e saj politik mbi të. Vetë Zogu bëhet nismëtar për këtë lloj marrëdhëniesh: Italia duket një partner më pak i rrezikshëm se Jugosllavia dhe Greqia. Paratë e Italisë bëhen një mbështetje vendimtare, madje e pazëvendësueshme, për qëndrimin e tij në pushtet, sikurse mund të saktësojë edhe vetë ai pas dëshimit të një vargu orvatjesh për t'u mëvetësuar ose për ta këmbyer me mbështetje të tjera të huaja.

Cilidoqoftë vlerësimi që mund t'i bëhet gjendjes ekonomike të Shqipërisë së Zogut, është e vështirë të hidhet poshtë varësia e saj e theksuar nga Italia, ndaj së cilës duket pothuaj si një koloni ekonomike. Megjithatë, Shqipëria nuk lejon të trajtohet si koloni. Zogu përpiqet të jetë aq më shumë autonom dhe të sigurojë garanci në këtë drejtim, sa më shumë që e kupton se është ekonomikisht i varur nga Italia. Mbreti i Tiranës mbron me vendosmëri lirinë e vet, me fjalë të tjera atë të vendit, të cilin e qeveris si ta kishte pronë të veten, përballë ndërhyrjeve në rritje të Musolinit në jetën e Shqipërisë.

Mund të përmenden në këtë drejtim qëndrimet e paparashikueshme dhe kryeneçe të mbajtura ndaj përfaqësuesve diplomatikë të Romës, ofertat e bëra ndaj fuqive perëndimore që ishin konkurrenca të Italisë, vendosja e marrëdhënies diplomatike me BRSS-në në vitin 1934, përpjekjet për të krijuar të tilla lidhje midis vendeve ballkanike, që do të kompensojnë deri diku kërkesat e tyre të vazhdueshme për ndihma dhe arbitrazh në drejtim të fuqive jashtë rajonit, sjellja e oficerëve anglezë në Shqipëri për të stërvitur dhe drejtuar xhandarmërinë mbretërore, vargu i krizave të shpeshta në marrëdhëniet italo-shqiptare.

Shqipëria nuk kthehet në një koloni italiane jo vetëm për hir të autonomisë politike. Në rast se Shqipëria ka përfitime të kufizuara nga ardhja e kapitaleve italiane, Italia duhet t'i konsiderojë me humbje investimet e bëra në këtë vend. Ivenstimet italiane në Shqipëri kanë një rezultat të dobët ekonomik, e nga ana tjetër nuk sjellin një rritje të përpjesëshme të ndikimit politik dhe një kontroll strategjik të këtij vendi të vogël ballkanik, që mund të përligjin përmasat e mjeteve financiare të lëvruara nga qeveria e Romës.

Aleksandro Roseli në studimin e tij mbi marrëdhëniet ekonomike italo-shqiptare gjatë njëzetvjeçarit të periudhës fashiste thekson:

Impenjimi i madh financiar i Italisë në Shqipëri nuk dha rezultatet e pritura as nga pikëpamja e bilancit tonë tregtar, për shkak se kapi-

talet e derdhura në Shqipëri u përdorën gjerësisht për të kryer blerje nga vende të treta duke financuar kështu deficitin e madh të një pjese të rrjedhshme të bilancit të pagesave të Shqipërisë, as nga pikëpamja e një shfrytëzimi të privilegjuar, në të dyja kuptimet, "ekskluziv" dhe "me çmim të ulët", të burimeve natyrore të truallit, sidomos të lëndëve të para dhe të prodhimeve bujqësore. Në këtë aspekt të fundit, shpresa për ta parë Shqipërinë të përfshirë në mënyrë funksionale në procesin e zhvillimit të vendit tonë, sidomos me anë të furnizimit me lëndë të para, në radhë të parë me naftë, mbeti e papërbushur. Veç kësaj, mbreti Zog që një borxhli i keq për Italinë: thithi hua të mëdha praktikisht pa i kthyer ato, pjesërisht për shkak të barrës së rëndë që do të sillte për ekonominë shqiptare shlyerja e borxhit, pjesërisht për shkak se ishte i vetëdijshëm se moskthimi i borxhit ishte çmimi që Italia paguante për ta mbajtur atë në orbitën e saj të ndikimit.

Bilanci pasiv i impenjimit financiar të Italisë në Shqipëri dhe në përgjithësi rezultatet e pakta të bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve ndikojnë me sa duket në zhvillimin e ngjarjeve të vitit 1939. Agresioni italian kundër mbretërisë së vogël merr së pari shkas dhe ky është një shkak thjesht politik, nga gara e Musolinit me Hitlerin. "Trofeu shqiptar" i duhet Musolinit për të mos rënë poshtë Hitleri në fushën e politikës ekspansioniste imperialiste. Por bindja se burimet e derdhura në Shqipëri janë ekonomikisht jofrytëdhënëse për Italinë peshon në vendimin përfundimtar që Musolini merr lidhur me fatin e Shqipërisë.

Investimet italiane në Shqipëri, pavarësisht nga forma në të cilën paraqiten, duke filluar nga huatë e deri te marrëveshjet e shfrytëzimit të minierave, nuk sjellin një ngritje të ekonomisë shqiptare dhe as të ardhura të mira për Italinë. Megjithatë, Shqipëria pajiset me infrastrukturën më të domosdoshme, sidomos ato rrugore. Ai që ka më shumë përfitim nga vërshimi i kapitaleve dhe nga shtimi i interesave italiane në Shqipëri është mbreti Zog, për sa kohë që një politikë e tillë nuk i sjell humbjen e fronit. Me shumat e dhuruara dhe koncesionet italiane Zogu paguan rrogat e nëpunësve të shtetit, shpërblen xhandarmërinë, mban Oborrin dhe përmbush trillet e familjes mbretërore. Pa qenë as shërbëtor i bindur i politikës italiane dhe as Sovran krejtësisht i pavarur, Zogu mban me Italinë marrëdhënie komplekse për të siguruar nga Roma ato që i nevojiten, duke mos hequr dorë përtej një kufiri të caktuar nga autonomia e vet.

Në këtë politikë të tijën Zogu përfiton nga paqartësia e vetë Italisë lidhur me objektivat që duhen ndjekur në drejtim të Shqipërisë. Gjatë viteve '20 dhe '30 qeveria italiane luhet vazhdimisht midis dy lloj politikave. Njëra ka për synim ta bëjë Shqipërinë një shtet të fortë, eventua-

lisht aleat, që të shërbejë në rast nevojë si mburojë përballë sllavëve dhe grekëve, të cilët konsiderohen armiq të Italisë. Tjetra parashikon një protektorat të Italisë mbi Shqipërinë ose një aneksim të saj, sikurse ndodh në vitin 1939, me anë të formulës së bashkimit të dy vendeve nën monarkinë sabaude. Zogu përfiton nga kjo politikë me dy regjistra, duke i përshtatur qëndrimet e tij ndaj atij orientimi, që sipas rastit mbizotëron në Romë. Shfaq respekt e nderim për fuqinë e Italisë, por në disa faza politike thekson kontrollin e tij të plotë e të padiskutueshëm për gjithçka që ndodh në Tiranë dhe në vend, me qëllim që në Romë të mos ushqejnë dyshime ndaj forcës së tij.

Zogu gjykon, dhe me të drejtë, se paratë e derdhura nga italianët në arkën e shtetit shqiptar janë jo aq një dëshmi miqësie sa një shpërblim, me qëllim që ai të mos e pengojë Italinë në Ballkan dhe të mos ia besojë vendin dashamirësisë gjithashtu me interes të fuqive të tjera konkurrenente të Italisë. Zogu vepron sikur të kishte qenë e shkruar që shteti shqiptar të jetojë me paratë e të huajve, por pa vënë në pikëpyetje pavarësinë. Njësoj si ai mendojnë edhe shumë shqiptarë të tjerë, që pranojnë të marrin para nga Italia. Bernd Fisher e komenton kështu politikën e ndjekur si nga italianët ashtu edhe nga jugosllavët me bajraktarët e Shqipërisë së Veriut, nga radhët e të cilëve vinte edhe Zogu: “Dhënia e shumave të mëdha e parave nga të huajt, sikurse ndodhte me shumicën e shqiptarëve, rrallëherë siguronte një besnikëri të përhershme. Fiset vepronin kryesisht sipas interesave të veta...”.

Pushtimi i vitit 1939

Më 7 prill 1939 trupat italiane pushtojnë Shqipërinë. Lëkundjet e politikës italiane ndaj Shqipërisë kanë marrë fund. Agresioni kryhet ditën e të Premtes së Zezë. Qëndresa e shqiptarëve, e dobësuar nga arratisja e menjëhershme e Zogut, është mjaft e dobët, kështu që italianët më 8 prill e fusin në dorë Tiranën. Korpusi italian i operacionit i përbërë prej 30.000 ushtarësh pëson humbje të pakta (12 të vrarë) dhe has vështirësitë më të mëdha kryesisht në bashkërendimin e rrëmujshëm të reparteve të veta.

Pushtimi i Shqipërisë është në përputhje me planet ekspansioniste të Musolinit, i cili në këtë mënyrë krijon për Italinë një pikëmbështetje në Ballkan vetëm 70 kilometra në vijë ajrore nga territori i vendit. Opinioni publik italian i paraqitet imazhi i një Shqipërie me burime të mëdha, tërheqëse si treg, por në të njëjtën kohë e prapambetur, e egër, e cila ka nevojë për një vëlla të madh që ta ndihmojë për t’u modernizuar e për t’u

qytetëruar. Gjithmonë është shikuar si i vlefshëm gjykimi i Ugo Ojetit, të dërguarit të “Corriere della Sera” në Shqipëri, dhënë vite më pare: “Cili vallë do t’ia arrijë dhe kur t’i bëjë këta individë të pamëshirshëm e anar-kikë një komb kompakt e të harmonizuar?”. Italia merr përsipër një rol të tillë, por objektivi është të përfshihet Shqipëria në projektin e “bashkësisë perandorake të Romës”. Sikurse deklaroi Dino Alfieri pikërisht ditën e agresionit: “Shqipëria përbën një pikëmbështetje, nga e cila do të mund të ndërmerreshin në mënyrë të natyrshme veprime të mëtejshme. Po shkojmë drejt ringritjes së Perandorisë Romake”.

Shqiptarët i presin me kundërshtim të mezifshetur italianët dhe rendin e tyre të ri. Reagimet ndërkombëtare ndaj agresionit nuk janë ku-shedi çfarë të ashpra, sikurse edhe kishte parashikuar qeveria e Romës.

Pushtimi italian i Shqipërisë vazhdon më se katër vjet, deri në shtator të vitit 1943. Fashizmi, pavarësisht nga planet e tij lidhur me këtë vend të vogël bashkanik, ka kohë vetëm për përvijimin e tyre. Ngjarjet e luftës, konflikti italo-grek, më pas qëndresa e armatosur e shqiptarëve, pengojnë çdo lloj planifikimi të politikës italiane për Shqipërinë. Projektet e fillimit janë të mëdha. Synimi është të mëkëmbet ekonomia shqiptare dhe të shkrihet ajo me ekonominë “e metropolit”. Ka mendime se shqiptarët mund të tërhiqen nga epërsia e qytetërimit italian deri në atë pikë sa të bëhen vullnetarisht fashistë e “romakë”. Në të vërtetë pushtimi bie në nivelin e një politike mjaft të rëndomtë.

Pasi kanë shpallur mbret të Shqipërisë Viktor Emanuelin III për të treguar kështu bashkimin me Italinë mbi bazën e një monarku të përbashkët, italianët vendosin ta qeverisin Shqipërinë me anë të një qeverie shqiptare, kompetencat e së cilës varen në thelb nga mëkëmbësi i mbretit të Italisë, post në të cilin zgjedhet Françesko Jakomoni, ambasador i Italisë në Shqipëri deri në çastin e agresionit. Ky e trajton Shqipërinë si cakun e vet privat. Politika e jashtme e Shqipërisë nuk është në kompetencë të Qeverisë shqiptare dhe trajtohet drejtpërdrejt nga Roma, ndërsa ushtria shqiptare përfshihet në kuadrin e ushtrisë italiane.

Në fillim ndiqet politika e italianizimit. Kujdes tregohet për përhapjen e gjuhës italiane dhe krijohet një parti fashiste shqiptare. Rezultatet janë të vogla.

Deri në vitin 1941 shqiptarët pranojnë në mënyrë pasive nismën italiane. Qëndresa e dobët e shqiptarëve në fazën e parë të pushtimit italian mund të shpjegohet me shpërpjesëtimin e raportit të forcave. Është e vështirë për një shqiptar të shpjerë nëpër mend që t’i kundërvihet fuqisë së Italisë, aq më tepër për sa kohë që Boshti duket sikur tregon një epërsi dërrmuese në luftën botërore. Veç kësaj, ekonomia shqiptare, së paku në

vitin e parë të pushtimit, ndjen ndikimin pozitiv të vërshimit të papritur të parave dhe të ndërmarrjeve italiane.

Qëndrimi i shqiptarëve ndryshon me disfatat e para italiane në fushatën kundër Greqisë dhe më pas me sulmin hitlerian në fushatën kundër Greqisë dhe më pas me sulmin kundër Bashkimit Sovjetik, çka i jep shtytje edhe në Shqipëri veprimtarisë së komunistëve. Politika ekonomike e Italisë në Shqipëri me kalimin e kohës sjell pasoja të dëmshme për një pjesë të popullsisë shqiptare, shtresat shoqërore më pak të favorizuara të së cilës pothuaj bien në gjendje urie. Italianët sjellin mallra në Shqipëri dhe investojnë kapitale, por pasuria grumbullohet në pak duar. Krijohen pasuri të mëdha, për shembull me anë të sistemit të lejeve të importit, mirëpo qarkullimi i paparë i mallrave dhe i parasë nuk përmirëson nivelin e jetës të masave, i cili përkundrazi goditet nga spiralla e inflacionit.

Italianët rrisin numrin e nëpunësve shtetërorë shqiptarë (nga 6.000 në 18.000), sikurse kishte bërë fashizmi edhe në Itali për të gjetur mbështetje dhe për të krijuar qëndrueshmëri shoqërore, mirëpo mjerimi i masave shkon në rritje. Krijimi i sistemit të asistencës kishte për të pasur ndonjë rezultat sikur të ishte shoqëruar me luftën kundër korrupsionit dhe kundër shfrytëzimit të ndërsjellë midis shqiptarëve dhe italianëve.

Përpyekjet e Italisë për të realizuar aneksimin janë të pakta. Përveç deklarimeve të bujshme lidhur me bashkimin me Italinë, ngjashmërinë italo-shqiptare, prejardhjen e përbashkët romake, epokën e re të begatisë që sjell fashizmi, zbatohet një politikë kompromisesh, e cila synon të sigurojë shfrytëzimin ekonomik të Shqipërisë dhe shndërrimin e saj në një bazë për ekspansionin ushtarak të italisë në Ballkan. Të bindur se kanë të bëjnë me një popullsi të zhvillar nga aspiratat kolektive dhe të pamësuar me konfliktet shoqërore, që karakterizojnë botën perëndimore më të zhvilluar nga aspiratat kolektive dhe të pamësuar me më të zhvilluar, italianët përpiqen që në ditët e para të pushtimit të gjejnë në radhët e shqiptarëve çfarëdolloj bashkëpunëtorësh jo fort të kushtueshëm, me anë të të cilëve do të qeverisnin vendin. Dhe i gjejnë tek paria e përherëshme, bejlerët e Shqipërisë së Mesme e të Jugut.

Në vitin 1941, pas fitores në luftën në Ballkan falë ndërhyrjes së gjermanëve italianët krijojnë një Shqipëri të Madhe, e cila përfshin një pjesë të madhe të trojeve që pretendon irredentizmi shqiptar në Kosovë, Maqedoni e Epir. Pavarësisht nga arsyet strategjike, që ndikojnë për krijimin e saj, Shqipëria e Madhe u siguron italianëve mirënjohjen e një numri të madh shqiptarësh. Atë që nuk e bëri paraja e bën realizimi i ëndrrës nacionaliste. Edhe në ditët tona shqiptarët nuk e kanë harruar se Shqipëria e Madhe u krijua në vitet 1941-44 nga italianët.

Miti shqiptar

Trajtimi mitik i Shqipërisë është mjaft i përhapur. Shqiptarët përpiqen të jenë legjendarë dhe përshtypjelënës. Joshqiptarët që vijnë në këtë vend largohen me mbresa të forta e të pashlyeshme (sidomos nga kontaktet e para). "Për një udhëtar që hyn në Shqipëri, -shkruhej në Athinë në vitet '30 të shek. XX, e drejta e lyp që në fillim të udhëtimit të hiqet dorë nga të gjitha elementet e krahasimit që ia sugjeron atij zakoni. Në Evropë është edhe Londra edhe Tirana..."

Letërsia mbi Shqipërinë është mbushur me një ndjenjë sikur kemi të bëjmë me një vend të pashoq e të pakrahasueshëm dhe kjo nuk ka të bëjë me kombësinë e autorëve. Shqipëria të magjeps. Shqipëria të largon. Gjithsesi nuk të lë të ftohtë.

Gjatë shekullit XX karakteri i pashoq i Shqipërisë është nxjerrë radhë pas radhë nga historia e mundimshme, nga gjuha e veçantë, nga peizazhi dhe nga natyra e pandotur, nga prapambetja dhe mjerimi, nga zgjedhjet politike radikale, nga *naïveté* dhe spontaniteti popullor, nga zakonet e lashta, nga përzierja e lindores me perëndimoren, nga pazari dhe xhamia krahas monumenteve klasike të Apollonisë dhe Butrintit, nga copëzimi dhe laryshia e vendit, nga e panjohura e zanafillës së tij.

Në vitin 1985 Odil Danielli shkruan: "E kaluara e Shqipërisë është e mbuluar nga një vello misteri" dhe "Shqipëria mbetet ende një vend mitik". Përkundrazi, *Revue des deux Mondes* në vitin 1990 nuk gjen asnjë mister tek Shqipëria:

Dhe vetëm mjedisi gjeografik do të mjaftonte pothuaj për të shpjeguar historinë e Shqipërisë [...] midis malesh të ashpra [...] Vetëm lugina e Shkumbinit dhe fusha bregdetare e Shkodrës e ndërpresin këtë peizazh rrëzimesh që ka modeluar shpirtin monolitik të shqiptarit [...] Natyrës mosmirënjohëse i përgjigjet një njeri ekstremist, ngjyrë bronzi nga jashtë, por edhe së brendshmi, që s'pyet për vdekjen, i ushqyer me ashpërsinë e klimës dhe me mundin që kërkon mbi jetesa. Kodi i nderit është i prerë sipas vetë profilit të maleve. Asnjë mëdyshje. E vërteta qëndron tek vdekja më tepër nga ç'mund të ndodhë për cilëndo perëndi tjetër [...] Fisi kundër fisit, shqiptari kundër shqiptarit, të bashkuar në një pikë, në mosbesimin e njëjtë ndaj të huajit. Po ai gjak në damarë, nga i cili dje rridhte ndërgjegjja kombëtare e një populli të paepur dhe krenar që sot zbulon në karikaturën e vet staliniane brishtësinë...

Italianët që e njihnin Shqipërinë nga koha e fashizmit ruanin kujtime të ndryshme: një vend "si Arkadia e lashtë", një vend i prirur drejt qyte-

tërimin evropian; një vend si "në fillim të mijëvjeçarit" i paprishur ende "nga marshimi i qytetërimit", një vend i pasur me burime dhe i destinuar romantikisht për një të ardhme të madhe, një vend fisesh anarkiste, një vend "punëtorësh të fortë, të përkorë, të ndershëm, krenarë". Libri i klasës së pestë në vitin 1933 u shpjegonte fëmijëve italianë se "territori i Shqipërisë është shumë i varfër, popullsia e paktë në numër merret pothuaj tërësisht me bujqësi dhe blegtori dhe shquhet për guxim".

Miti i karakterit të pashoq të Shqipërisë riprodhohet nga njëra epokë në tjetrën me një dozë të mirë retorike. Nuk ngjall habi fakti që autorët e drejtimeve të kundërta, si ata fashistë ose, nga ana tjetër, ata komunistë, të gjithë ideologjikisht të dashuruar pas Shqipërisë pavarësisht nëse kanë qenë italianë, francezë, anglezë ose gjermanë, kanë himnizuar në epokë të ndryshme Shqipërinë e vogël me të njëjtën retorikë për natyrën magjepëse, qiellin e kulluar dhe detin e kaltër, luginat e bleruara dhe bregdetin plot diell. Të tjerë, përkundrazi, e kanë trajtuar Shqipërinë në mënyrë negative, duke vënë në pah gjendjen e saj si të një periudhe parahistorike ose ballkanizimin e mbështjellë me intriga, ksenofobi, anarki politike. Shqipëria ka qenë për shumëkë një prizëm përmes së cilës kanë projektuar ëndërrat ose ankthet e tyre, Shqipëria ka qenë toka e njeriut të lirë ose e njeriut barbar; e "njeriut të ri" ose e njeriut primitiv; e lirisë ose e tiranisë, e komunizmit të realizuar ose e gulagut të pragu i derës.

Shqiptarët kanë ndikuar fuqimisht në përhapjen e mitit të tyre. Thonë se janë "populli më i lashtë i Evropës", ose së paku "populli më i lashtë i Ballkanit". Ilirët e lashtësisë qenkëshin pa asnjë periudhë ndërprerje shqiptarët e sotëm.

Në Luftën e Dytë Botërore, disa drejtues shqiptarë ua bënë qejfin gjermanëve duke deklaruar se ishin "arianët e Ballkanit". Vitet e shkuara ndonjë nëpunës gjerman i bashkëpunimit habitej kur në Shkodër dëgjonte t'i pohonin të gjithë po këtë besë ariane. "Ilir" dhe "Arjan" janë dy emra shqiptarë tipikë për periudhën e re nacionalkomuniste.

Enver Hoxha kishte përhapur nëpër qytete shqiptare plot muze historike, etnografike, folklorike, arkeologjike me qëllim që të mbështeste tezën e prejardhjes së lashtë ilire të shqiptarëve. Edhe muzetë ushtarakë kishin për funksion të provonin zanafillën e pretenduar dhe pranë armëve moderne shihje të ekspozuara ato të "ilirëve neolitikë", si në Muzeun e Armëve në Gjirokastër. Në Muzeun Historik të Tiranës disa vite më parë ishin ekspozuar shkopinj të stërmëdhenj, ose më saktë çomanga, vendosur pranë ekspozateve të kohës së qëndresës antinaziste.

Natyrshisht, historia studiohej nëpër universitete shqiptare duke treguar një vëmendje të posaçme për funksionin e *nationbuilding*.

Zanafilla ilire ishte dhe mbetet politikisht e dobishme për shqiptarët, po të mbahen parasysh pretendimet territoriale me popujt fqinj. Edhe serbët, grekët, maqedonët e bullgarët i kërkojnë me kënaqësi të parët e tyre në epoka sa më të lashta që të jetë e mundur. Dhe, kur mundësitë janë të kufizuara, sllavët e parë kanë mbërritur siç dihet në Ballkan në shekullin VII, atëherë vënë në diskutim lashtësinë e të tjerëve. Në Beograd lidhja midis ilirëve dhe shqiptarëve është vënë kurdoherë në dyshim. Përkundrazi, në Athinë ekziston prirja për të mos bërë dallime midis ilirëve të lashtë dhe popullsive të lashta helene.

Nuk mund të thuhet se në ç' masë shqiptarët e sotëm janë pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve ose të fisit tjetër të afërt me ta, dardanëve. Gjuha, kjo vërtet unike, as serbe as greke, duket se dëshmon një zanafillë etnike origjinale. Pa dyshim, për shqiptarët vlen ajo që do të mund të thuhet edhe për popujt e tjerë ballkanikë: pastërtia etnike nuk ekziston. Në trojet iliro-shqiptare kanë ardhur dhe kanë jetuar për një kohë të gjatë grekë e romakë, fise të ndryshme barbare, bizantinë, venecianë, bullgarë, serbë, malazezë, normanë, turq, anzhuinë, hebrenj, ciganë, vllahë, italianë. Fizionomitë dhe tiparet e shqiptarëve, të plazmuara deri diku nga mënyra dhe niveli i jetesës, janë aq të larmishme sa që përjashtojnë shartimin mekanik të një etnie të pastër shqiptare në një trung gjithaq të pastër ilir.

Një tjetër shtyllë e besimit tek shqiptarët mbështetet në të qenit një popull luftëtar. Pa dyshim, populli shqiptar është përfshirë në shumë luftëra, ka praktikuar në masë zanatin e armëve, ka qenë i detyruar të mbrohet nga orvatjet e vazhdueshme për ta pushtuar dhe asimiluar. Kjo histori luftërash ka lënë mbresë në vetëpërfytyrimin e shqiptarëve si luftëtarë të pashtuar, që gjithmonë luhaten midis pathyeshmërisë dhe fatit të keq. Në botimin zyrtar *Réponses aux questions sur l'Albanie*, dalë në Tiranë më 1969, pyetja mbi identitetin shqiptar merr përgjigjen "një popull që ka çarë gjithmonë rrugën e historisë me shpatë në dorë".

Nuk është e mundur të përcaktohet nëse shqiptarët kanë vuajtur më shumë se popujt fqinj për lirinë dhe pavarësinë e tyre. Çdo popull ballkanik ka pasur vuajtjet e veta në kohën moderne, kohë e popujve në luftëra. Shqiptarët kanë pjesën e tyre të fatkeqësive dhe të mundimeve. Janë të dobët nga pikëpamja demografike dhe politike në fillim të shekullit XX, kur shembja e Perandorisë Osmane i shtyn – të fundit midis të gjithë popujve ballkanikë, sepse si aleatë të Portës së Lartë deri në agoninë e saj – luftojnë jo më për autonomi të gjerë brenda Perandorisë, por për pavarësinë kombëtare.

Nga viti 1912 deri në vitin 1920 Shqipëria njih pushtues pas pushtuesi: grekët, serbët, austriakët, italianët, francezët, bullgarët. Disa janë haptazi pushtues, të tjerët hiqen si miq, por kanë, megjithatë, synim për të

vënë nën kontroll vendin. Në periudhën midis dy luftërave botërore Shqipëria mbetet në qendër të politikave ekspansioniste jugosllave, italiane dhe greke. Në vitin 1939 ndodh pushtimi italian. Pas 8 shtatorit 1943, gjermanët ua zënë italianëve vendin e pushtuesit. Fill pas luftës Titoja desh ta bënte Shqipërinë një provincë të federatës së ëndërruar ballkanike, pra të perandorisë së vet. Enver Hoxha mezi arrin të ruajë pavarësinë e vendit. Në vitet 1949-51 amerikanët dhe anglezët e kthejnë Shqipërinë në bankoprovë të përmbysjes së një regjimi filozovjetik, duke synuar të nxisin një guerrilje brenda vendit. Nëse këto janë ngjarjet e Shqipërisë historike, pra të shtetit të Tiranës, shqiptarët jashtë kufijve janë në mëshirë të popujve dhe të shteteve të tjera.

Pavarësia e vonë dhe e kundërshtuar së bashku me pavarësinë e papërfunduar të shqiptarëve në fqinjësi krijon tek shqiptarët vetëdijen e një populli luftarak për shkak të kërcënimeve të pareshtura. Epoka e Enver Hoxhës e shpreh në mënyrën më të plotë këtë vetëdije nëpërmjet këmbënguljes paroksishte tek rrethimi i vendit, bunkerët dhe fortifikimet e tjera ushtarake, lënia pas dore e rrugëve të brendshme për të penguar pushtuesit e mundshëm, tek autarkia ekonomike, zgjedhja e aleatëve në skajet e kundërta të globit, politika e rritjes demografike (një shqiptar më shumë, një pushkë më shumë). Në vitin 1976 Mehmet Shehu, zëvendësi i ashpër i Hoxhës, deklaroi, duke iu referuar kërcënimeve nga Perëndimi dhe nga Lindja: "Sigurisht se Shqipëria socialiste është i vogël, i rrethuar, nën presionin e bllokadës, por ngrihet si shkëmb graniti në oqeanin e madh e të pabesë imperialist e revizionist".

Një veçori ngjall vazhdimisht admirimin e atyre pak njerëzve nga Perëndimi, që arrijnë të vizitojnë Shqipërinë e Enver Hoxhës: shtatorët e Skënderbeut ua kalojnë për nga përmasat atyre të etërve të nderuar të komunizmit. Dhe, kjo në një kohë që regjimi pohon deri në obsesion se zë vendin e parë për sa i takon ortodoksisë marksiste-leniniste. Skënderbeu, *athleta Christi* për papët e shekullit XV, himnizohet nga diktatori, i cili "ndalon" besimet fetare.

Por epopeja e Skënderbeut (1405-1468) mbetet në qendër të bisedave për luftë të shqiptarëve. S'ka rëndësi fakti se kujtimi i tij për shekuj me radhë është ruajtur më shumë në Perëndimin e krishterë sesa në Shqipërinë e osmanizuar. Skënderbeu është një model shqiptarie, një sinonim i sistemit shqiptar të vlerave.

Historia e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut paraqet interes për faktin se për njëzet e pesë vjet me radhë ky feudal shqiptar arrin të ndalojë përparimin e turqve drejt Adriatikut. Mehmeti II ia del të marrë Kostandinopojën, mirëpo tri rrethime të fuqishme nuk i lejojnë të marrë Krujën. Emri i Skënderbeut bëhet i njohur në oborret perëndimore. Rreth tij

ekziston një bibliografi e gjerë që përfshin mijëra tituj në njëzet gjuhë të ndryshme. Domethënia e heroit për identitetin shqiptar mund të nxirret nga tekstet që kanë shenjtëruar figurën e tij tek populli i vet, duke filluar nga jetëshkrimi i priftit shkodran Marin Barleti i vitit 1508-1510 deri tek ai i shekullit XX i Fan Nolit.

Sipas interpretimit të zakonshëm të shqiptarëve, shembulli i Skënderbeut për popullin e vet qëndron para së gjithash në trimërinë dhe aftësinë luftarake. Skënderbeut i referohen shënimet e atij kronistit turk, i cili në shekullin XV i përshkruan shqiptarët si “tigma që luftojnë edhe me retë që kalojnë mbi kryet e tyre”. Por karakteri shembullor i Skënderbeut qëndron edhe në faktin se ishte një kryetar i nderuar nga të gjithë; në personalitetin e tij të rrëmbyer e kokëkrisur; në vullnetin për të bashkuar popullin në luftë kundër pushtuesit; në mbrojtjen e paepur të feudit të familjes të konfiskuar nga turqit, pra në mbrojtjen edhe të nderit të familjes; në besnikërinë ndaj babait të shpronësuar nga armiqtë; në lidhjen e tij me Evropën. Skënderbeu, ashtu si edhe shqiptarët gjatë gjithë historisë, kalon nëpër besime të ndryshme fetare, duke filluar me katolicizmin, myslimanizmin në periudhën e fëmijërisë pranë osmanëve dhe gjatë shërbimit ushtarak për gjysmëhënë, së fundi përsëri i krishterë në luftën antiturke. Vetë emri Skënderbe shpreh krishtërimin e myslimanizëm bashkë; emri mysliman Skënder vjen nga Iskander, Aleksandër, me shtojcën bej, që është titull nderi tek turqit.

Njësoj si popujt e tjerë ballkanikë edhe populli shqiptar ka një ndjenjë të theksuar viktimizimi. Njësoj si ata e sheh historinë e vet si një histori të tragjedive të mëdha. Protonacionalizmi shqiptar formohet mbi bazën e veprave të Vaso Pashës, poetit të shqiptarizmit. Në një poemë të tij të njohur të vitit 1880 ai i drejtohet vendit të vet me fjalët *Shqipëri, e mjera Shqipëri*. Letërsia shqiptare, duke filluar nga Vaso Pasha e Gjergj Fishta e deri te Ismail Kadareja është plot epepo luftërash, gjakderdhjesh, atmosferash epike, mitesh popullore. Shkurt, plot me etnocentrizëm, por edhe me viktimizim romantik.

Në Ballkan çdo popull ankohet se ka pësuar një varg spastrimesh etnike ose së paku politikash asimiluese nga ana e fqinjve, duke mbajtur pastaj ai vetë të njëjtin qëndrim sa herë që është në gjendje të bëjë diçka të tillë. Ngjarjet e një shtypjeje të ndërsjellë nuk ngjallin një *pietas* të ndërsjellë, por vetëm viktimizime kolektive qaramane. Shqiptarët janë përfshirë në këtë histori viktimash dhe xhelatësh, e cila mund të kuptohet plotësisht, në rast se ndiqet gjithë rrjedha e shekujve. Por ata, ndoshta edhe më shumë se popujt e tjerë fqinj, ushqejnë një ndjenjë të fortë viktimizimi edhe ndaj zhvillimeve të brendshme.

Në epokën e Enver Hoxhës viktimizimi shfaqej haptazi në lidhje me periudhën e Shqipërisë osmane. Nën sundimin e gjysmëhënës Shqipëria paska qenë lënë pas dore, paska qenë qeverisur keq, osmanizuar, orientalizuar, ndonëse shqiptarët përbënin një grup të privilegjuar në perandori. Përkundrazi, në vitet e fundit ankesat dëgjohej për fatkeqësinë gjysmëshekullore të komunizmit real. “Ju nuk mund ta kuptoni” – është refreni, që në vitet e para ’90 vizitorët perëndimorë dëgjojnë nga eksponentët e Shqipërisë së re. Qeveria e Hoxhës konsiderohet nga antikomunistët shqiptarë si më e keqja e gjithë historisë së vendit: terror, kampe përqendrimi, spastrime, spiunime, uri, shfrytëzim, skllavëri materiale dhe morale.

Dëshmitë e atyre që kanë përjetuar diktaturën shpesh ruhen me fisnikëri të madhe ekzistenciale dhe nënvizojnë karakterin unik të kësaj përvoje historike. Një shkrimtar shqiptar në shtator të vitit 1995 deklaroi në një program televiziv italian: “Do të vijë dita që bota të mësojë se vendi im është më i pasuri në botë jo me minerale, por me tragjedi”. Mauricio Kostanco pyet për periudhën komuniste. “Ju nuk mund as t’i merrni me mend këto gjëra, janë të pabesueshme”. Ky përshkrim i rrallë më pastaj vijon:

Duhet ta dini se vendi im është vend tragjik.. Është fqinji juaj më i afërt, i cili për shkak të padrejtësive të Fuqive të Mëdha ka dy të tregatat e trojeve të veta jashtë kufijve shtetërorë. Është një vend i pasur me burime natyrore, por është i varfër sepse e kanë qeverisur keq. Tani ka nisur një jetë të re, një jetë demokratike. Është një qeveri e brishtë demokratike, sepse nuk është në gjendje të zgjidhë të gjitha problemet e trashëguara prej një regjimi që ka shkatërruar vendin, ka rrënuar ekonominë dhe ka marrë në qafë një popull të tërë. E kuptoj se edhe qeveria nuk di nga t’ia mbajë për zgjidhjen e këtyre problemeve... Demokracitë perëndimore nuk i kanë mbështetur këto demokraci të brishta. Ato kanë nevojë për mbështetje. Shqipëria synon të bëhet një vend normal, por nuk mundet sepse sapo është kthyer nga një lager në një Pazar. Paraqitet si vend perëndimor, por fshihet përbrenda tërë ato mendësi prej bote të tretë, tërë atë çorganizim. Evropa duhet ta kuptojë se shqiptarët luftojnë për ekzistencë, për mbijetesë. Kanë humbur madje edhe arsyen... Ata e dinë se duhet të vdesin herët apo vonë, prandaj më mirë të vdesin në vijën e parë. Por marrin rrugën më të rrezikshme, me barka, etj. Kanë humbur edhe ata, sepse kush është i uritit humb arsyen, nuk arsyeton drejt. Unë jam i bindur se një ditë do të kthehen, sepse atje po shkojnë shumë të huaj për të fituar. Por a është Shqipëria vërtet e pashoqe dhe e pakrahasueshme?

Vitet e krizës

Kriza e filluar në nëntor të vitit 1996 i solli dëme të jashtëzakonshme Shqipërisë. Me qindra shqiptarë mbetën të vrarë ose të plagur rëndë, në shumicën e rasteve në mënyrë aksidentale pas përhapjes në masë të armëve të zjarrit. Dy të tretat e shqiptarëve humbën një pjesë të madhe të kursimeve të tyre. Pati shkatërrime e plaçkitje në shkallë të gjerë: një tërbim vetëshkatërrues i një populli të pajisur dobët me ndjenjën e së mirës së përbashkët; një revoltë njerëzish të egërsuar nga mashtrimi; përlllogaritje politike nga ana e disa njerëzve. Shqiptarët e diasporës, që përbëjnë gati gjysmën, që nga Prishtina e deri në Shkup ndjehen të dërrmuar shpirtërisht dhe të dobësuar në garën e ashpër etnike ballkanike jo më pak se bashkëkombësit e tyre të Republikës së Shqipërisë.

Imazhi ndërkombëtar i Shqipërisë së re paskomuniste u dëmtua rëndë, e të mos flasim për atë të udhëheqjes së saj politike. Italia, vendi i referimit për shqiptarët, tregoi një paragjykim të përgjithshëm për shqiptarët, të cilët opinioni i gjerë publik i krahasonte me ca të murtajosur. Italianët racistë, që doli se nuk ishin të paktë, i vunë shqiptarët në krye të listës së përbuzjes, përbri ciganëve.

Rrugëdalja nga kriza qëndron tani në aftësinë e forcave politike shqiptare për të bashkëpunuar midis tyre. Midis demokratëve dhe socialistëve marrëdhëniet janë fare të helmatisura. Po e përdor këtë shprehje për të treguar që ballafaqimi është thelbësor. Për fat të keq, mllëfi midis palëve politike ka një themel jo vetëm ideologjik, por edhe personal. Berisha në këto muaj krize të lë përshtypjen e një luani të plagosur, që sheh ngado pusi e gracka dhe ndikon nga ana e vet për ta helmatisur më tej konfliktin politik. Kreu i socialistëve, Fatos Nano, sapo ka dalë nga burgu pas një dënimi në thelb politik, i falur prishaqefas nga një president, i cili më nuk mund të vepronte ndryshe. Burgjet ishin boshatisur nga të gjithë të burgosurit e tjerë dhe Shqipëria ishte kthyer në “vendin e parë në botë pa burgje”. Si në Partinë Demokratike ashtu dhe në Partinë Socialiste është ndezur debati i brendshëm midis skifterëve dhe pëllumbave. Përpjekjet për një kompromis të arsyeshëm ndërthuren me përpjekje agresive. Autoriteti i Berishës është vënë në diskutim edhe në radhët e demokratëve, por mungon guximi për ta kundërshtuar haptazi nga frika e reprezalieve jo vetëm në rrafshin politik.

Qeveria aktuale ka dalë nga një marrëveshje pajtimi kombëtar dhe, ndonëse tensioni midis dy partive më të mëdha mbetet i fortë, ajo shënon në njëfarë mënyre vijën politike për të cilën Shqipëria ka nevojë. Megjithatë, midis qeverisë dhe presidencës, domethënë Berishës, ekziston një rivalitet i fortë. Përderisa qeveria nën udhëheqjen e socialistëve po ndry-

shon ca nga ca kreun e forcave të armatosura dhe të policisë, Berisha po organizon një gardë presidenciale të veten të armatosur mirë.

Zgjidhja politike për Shqipërinë nuk qëndron domosdo në heqjen e Berishës nga pushteti. Në të vërtetë, presidenti përbën një garanci të paktën për një pjesë të Veriut. Veç kësaj ai ka në dispozicion mjete ushtarake: policinë personale dhe bandat e veriut që quhen pikërisht bandat e Berishës. Ta largosh Berishën nga pushteti pa zgjidhje me konsensus e me marrëveshje do të thotë të rrezikosh të biesh në luftë bandash, ose edhe më keq. Çdo krah politik ka tani armë dhe mund të parashikohet se nuk do t'i dorëzojë ato së afërmi. Nga ana tjetër, shtrohet pyetja se si do të qeverisnin socialistët, këta trashëgimtarë të famëkeqes Parti e Punës, po të ishin të vetëm në pushtet. Prandaj, duhet uruar arritja e një marrëveshjeje midis demokratëve dhe socialistëve.

Forca ushtarake shumëkombëshe e dërguar në Shqipëri në mbështetje të një vendimi të OKB-së mund të jetë mjaft e dobishme. Funksioni i saj qëndron në shpërndarjen e ndihmave të veçanta humanitare që nevojiten sidomos në disa qytete e rrethe ku anarkia pengon furnizimin e rregullt dhe, mbi të gjitha në mundësimin e rivendosjes së rendit publik jo vetëm me ruajtjen e rrugëve të komunikimit dhe shpërndarjes së ndihmave, por edhe me riorganizimin me anë instruktorësh dhe mjetesh të përshtatshme të policisë dhe të shtetit shqiptar.

Përvoja e javëve të para të misionit "Alba" duket mjaft pozitive. Falë pranisë së forcës shumëkombëshe të ruajtjes, u bë i mundshëm përmirësimi i gjendjes sociale dhe rifillimi i një veprimtarie të dukshme ekonomike në Shqipëri. Pas çasteve të para të pasigurisë dhe skepticizmit, popullsia i priti ushtarët e misionit me ngrohtësi të madhe duke befasuar të gjithë ata që parashikonin një pritje armiqësore ose së paku mosbesuese. Qëndrimi i mirë dhe me respekt i mbajtur nga trupat e huaja gjeti kudo jehonë në sjelljen dashamirë të popullsisë shqiptare.

Roli frenues i luajtur nga misioni ndërkombëtar është i dukshëm, ndonëse për të kontrolluar plotësisht territorin e thyer shqiptar do të ishin nevojitur shumë më tepër trupa: ekspertët ushtarakë përllëgarisnin se do të nevojiteshin së paku 50.000 ushtarë në vend të 6.000 sih që ndodhen aktualisht. Atje ku është dislokuar "Alba" kriminaliteti ka rënë, sikur edhe veprimtaritë e paligjshme, uzurpimet e objekteve, mungesa e shërbimeve, përvetësimet e parregullta, shkatërrimi i strukturave të përbashkëta. Lajmet e përditshme që vijnë nga Shqipëria nxjerrin vazhdimisht në pah vrasje dhe krime që ndodhin atje. Kjo e bën opinionin publik perëndimor të dyshojë për dobinë e misionit të armatosur ndërkombëtar. Megjithatë, po të mungonte forca shumëkombëshe gjendja në Shqipëri do të ishte edhe më e keqe.

Popullsia shqiptare shpreson që misioni “Alba” të vazhdojë gjatë dhe ta zgjerojë mandatin e tij në sektorët e rendit publik, të rindërtimit të infrastrukturave kryesore, të funksionimit të shërbimeve, në veçanti kontrollat higjienike.

Kritikat e mjeteve perëndimore të informacionit ndaj misionit “Alba”, kritika që nuk janë të pathemelta për sa i takon ngushtësisë së mandatit, bashkohen pa dashur me pakënaqësinë e të gjithë atyre që si presidenti Berisha do të dëshironin largimin e shpejtë të forcës shumëkombëshe për të pasur mundësinë e zbatimit të planeve të tyre të veprimit politik pa kushtëzime nga jashtë.

Shqipëria nuk do ta marrë dot veten vetë, por patjetër do të ketë nevojë për mbështetjen ndërkombëtare. Edhe në periudhën më të re të historisë së saj ajo nuk ka qenë kurrë në gjendje të ecë përpara me forcat e veta. Italianët ndihmuan mbretin Zog. Jugosllavët, sovjetikët dhe kinezët njëri pas tjetrit ndihmuan Enver Hoxhën. Të gjithë nga pak e kanë ndihmuar Shqipërinë paskomuniste. Ka të ngjarë që në të ardhmen ajo do të duhet ndihmuar ende, me qëllim që të shmanget prania e një vendi të çorientuar në zemër të Evropës.

Ndonëse më nuk është koha e protektorateve, Shqipëria duhet të pranojë forma kontrolli mbi jetën e saj ekonomike dhe politike në rast se synon të fitojë strukturën e një shteti evropian. Shqiptarët e ngatërrojnë lehtë interesimin e huaj për zhvillimet e tyre me ndërhyrjen e padrejtë dhe planet për ekspansion imperialist. Kemi të bëjmë me një qëndrim mendor që ka arsyet e veta të përhapjes në Ballkan. Por, kësaj radhe shqiptarët mund të jenë të sigurt, së paku në lidhje me shtetet evro-perëndimore, se përfshirja në punët e tyre nuk është diktuar nga synime ekspansioniste për territor ose treg; interesi është në të vërtetë për të mos pasur në Evropë një vend-vatër që në të ardhmen mund të kthehet në qendër të pasigurisë në Ballkan dhe të trafiqeve të paligjshme nga më të ndryshmet.

Është pozitive që shqiptarët e kuptojnë gjendjen shpirtërore të zhgënjyer e të bezdisur të perëndimorëve ndaj tyre. Dëshira e shqiptarëve për të bërë pjesë në Evropë, domethënë për të marrë pjesë në lirinë dhe mirëqenien e saj, do të realizohet në atë masë sa Tirana do të jetë një partner i besueshëm për qeveritë e ndryshme evropiane. Evropa ka rregullat e saj dhe kërkon që të përmbushen disa detyra. Prandaj, është e nevojshme që shqiptarët të përballojnë ballkanizimin, në dukje të pazgjidhshëm, pre e të cilit janë.

Shqipëria duhet të gjejë forcë për harmoninë dhe bashkimin në mënyrë që të kapërcejë gjendjen e tanishme të anarkisë. Po t’ia arrijë kësaj, bashkësia ndërkombëtare do ta mbështesë ashtu si ka bërë deri më sot.

Ndryshe parashikohet një politikë e kontrollit të rreptë, e shtrëngimeve poshtëruese, në mos edhe e kordoneve të mirëfillta sanitary, gjë që do të ishte një zgjidhje e zymtë për një vend që sapo ka dalë nga dekadat e izolimit dhe të cilit nuk i mungojnë forcat e nevojshme për të ndërtuar të ardhmen e tij të qetë.

Roberto Morozo della Rocca

THE ALBANIAN ISSUE IN THE BALKANS

Summary

Albanians are not the only ones in the Balkans to dream about a greater state-nation. A great number of Albanians are currently living outside the borders of the Albanian state. Around two million Albanians live in Kosova confronting in a fierce way the Serbs and their discriminatory policies. In Macedonia, which lacks state tradition, but which has been established as an independent state following Yugoslavia's dismemberment, an Albanian population lives, pretending to make up 40% of country's population, if not more. Its entire western zone bordering on Albania is densely populated by Albanians making it so easy to envisage an extension of the Tirana sovereignty zone over these areas in case that the new republic dissolves.

In Kosova Albanians are exposed to a hostile police regime having been expelled from public structures. The Serbian plan starting from 1994 at least, aimed at making their living in Kosova too difficult so that they would move out. In fact, around 300.000 Albanians of Kosova, a great number of them of recruitment age, have left. As a counteraction, Albanians declared in a clandestine plebiscite on October 1991 their independence from Serbia, which has not been recognized by any state, with the exception of Albania. Besides, they have elected their Parliament and President Ibrahim Rugova, an aristocratic intellectual with nuances of the past century's patriotism, who became known as some kind of a "Balkan Gandhi" or "Albanian Havel".